

THIRRJE PËR KONFERENCË NDËRKOMBËTARE

“RISI DHE PRAKTIKA BASHKËKOHORE NË GJUHËSI, MËSIMDHËNIE, PËRKTHIM, LETËRSI DHE KULTURË”

DATA: 20 nëntor 2025

VENDI: Fakulteti i Gjuhëve të Huaja

Keynote speaker:

Tatjana Slijepcevic English Connects Lead - Wider Europe, British Council

Departamenti i Gjuhës Angleze organizon Konferencën e 15-të Ndërkombëtare e cila vjen në mbështetje të studimeve ndërdisiplinore që sjellin zhvillimet më të fundit teorike dhe praktikë më bashkëkohore në fushat e gjuhësisë, mësimdhënies, përkthimit, letërsisë dhe kulturës.

Konferenca synon të bëjë bashkë studiues dhe akademikë të njohur, kërkues shkencorë të disiplinave të ndryshme gjuhësore apo studimeve ndërdisiplinore, duke i ftuar të shkëmbejnë përvoja, praktika dhe gjetje kërkimore nëpërmjet punimeve origjinale.

Punimet shkencore të paraqitura gjatë konferencës do të përfshihen në aktin e botimeve, i cili do të kontribuojë në pasurimin e literaturës shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Gjuhët e konferencës: Anglisht / Shqip

✉ Adresa e e-mailit: konferenca.anglisht@unitir.edu.al

Data të rëndësishme:

👉 Afati për dërgimin e abstraktit: **7 nëntor**

👉 Njoftimi për pranimin e abstraktit: **12 nëntor**

👉 Afati për dërgimin e punimit të plotë: **23 janar 2026**